



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

Up1 Nr. 03-124

15.04.2022

Sh k u p

Bazuar në nenin 18 paragrafi 1 alinea 20 dhe nenin 23 paragrafi 1 alinea 1 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20 и 77/21), dhe në lidhje me nenin 53 paragrafi 5 dhe nenin 17 alinea 2 nga po i njëjti Ligj, pika 4 i Udhëzuesit për përcaktim të afatit për veprim sipas vendimit të Agjencisë për marrjen e masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-6039/1 nga 20.10.2015, Raporti me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.10-1280/1 nga 29.03.2022, dhe në pajtueshmëri me Konkluzionin nr.02-1682/7 nga 15.04.2022, Këshilli i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, në seancën e 15-të e mbajtur më 15.04.2022, miratoi si në vijim:

Vendim

për shqiptim të masës – vërejtje publike

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria tregtare radiodifuzive Televizioni SITEL SHPKNJ, Shkup, për shkelje të nenit 53 paragrafi 5 dhe paragrafi 17 alinea 2 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele (LSHMAAV), në mënyrën që brenda kornizave të shërbimit televiziv programor, më datë 21, 22 dhe 23 shkurt 2022., ka transmetuar spote tele-shopping për produktet „Bronho protekt-500ml.“ dhe „Diabetol Forte-30 kapsula“ operatorit ushqimor „Natyra Terapi“ SHPKPV Shkup, në të cilën në mënyrë të përgënjeshtuar është prezantuar natyra e tyre dhe karakteristikat, dmth ato janë të pavërteta dhe të pandershme, me të cilën e mashtrojnë publikun dhe janë në kundërshtim me interesat e konsumatorit.
Shkelja nga paragrafi 1 i kësaj pike, është specifikuar dhe në Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore, ark.nr.10-1280/1 nga 29.03.2022., e cila është pjesë plotësuese e Vendimit si Shtojcë nr.1.
2. DETYROHET SHTR Televizion SITEL SHPKNJ Shkup, menjëherë pas pranimit të Vendimit të harmonizojë punën e tij me dispozitat nga LSHMAAV.
3. Të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrur, i paraqitur në pikën 1 i këtij Vendimi, veprimi sipas Vendimit.
4. Ky Vendim është përfundimtar, si ditë e miratimit të tij llogaritet dita e verifikimit në arkivën e Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele (Agjenci).

A r s y e t i m

Agjencia bazuar në nenin 28 nga LSHMAAV ka kompetenca të kryejë mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të radiodifuzerëve dhe dhënësve të shërbimeve audiovizuele sipas kërkesave, si dhe të paketave programore që i ritransmetojnë operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik në aspekt të respektimit të dispozitave nga Ligji i cituar, lejet, certifikatat e dhëna për regjistrim, akteve nënligjore dhe akteve të tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi 1 alinea 1 nga LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë morri masë – vendim për vërejtje publike në rastet kur kemi shkelje të dispozitave nga LSHMAAV dhe akteve nënligjore të miratuara nga vetë Ligji, si dhe të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në leje dhe akteve të tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 53 paragrafi 5 nga LSHMAAV janë të ndaluara komunikime komerciale audiovizuele me të cilat është përgënjeshtuar natyra, karakteristikat, kualiteti ose origjina gjeografike e produktit, shërbimet ose aktivitet komerciale. Komunikimet komerciale audiovizive duhet të jenë të vërteta, të mos mashtrojnë publikun dhe të mos jenë në kundërshtim me interesat e konsumatorit (paragrafi 17 alinea 2)

Në kuadër të ingjencave të saja Ligjore, Agjencia përmes Sektorit për çështje programore, më 28 mars 2022, ka kryer mbikëqyrje të jashtëzakonshme programore (monitorim) ndaj shërbimit programor televiziv SHTR Televizion SITEL SHPKNJ Shkup, të transmetuara më datë 21, 22 dhe 23 shkurt 2022, në nivel shtetëror, ku u konstatua shkelje të nenit 53 paragrafi 5 dhe paragrafi 17 alinea 2 nga LSHMAAV. Mbikëqyrja

e jashtëzakonshme ishte realizuar pas njoftimit nga Agjencia për ushqim dhe veterinar (AVU) për komunikime komerciale audiovizuale të paligjshme për shtesa ushqimore, dhe në kuadër të Memorandumit për bashkëpunim ndërmjet Agjencisë dhe AUV, lidhur më 14.04.2021.

Pra, në spotet tele-shopping për shtesa ushqimore „Bronho protekt-500 ml.“ („Broncho Protect – 500 ml.“) dhe për ushqimin e operatorit ushqimor për qëllime mjeksoere, „Diabetol forte-30 kapsuli“ („Diabetol Forte“), i operatorit ushqimor „Hatura terapi“ SHPKNJP Shkup, transmetuar disa herë më 21, 22 dhe 23 shkurt 2022, janë shfrytëzuar materiale vizuale dhe thënie verbale që sugjerojnë pretendime shëndetësore dhe/ose ushqimore, si dhe deklarata për produkte të cilat nuk janë miratuar nga Agjencia e ushqimit dhe veterinarisë. Me spotet tele-shopping me përgënjeshtim prezantohet natyra dhe karakteristikat e produkteve „Bronho protekt-500 ml.“ dhe „Diabetol forte-30 kapsula“, dmth nuk janë të vërteta dhe të pandershme, mashtrojnë publikun dhe janë kundër interesave të konsumatorëve. Konstatimet në raport janë bazuar në analizë eksperte mbi llojet e komunikimeve komerciale audiovizuale të regjistruara me monitorimin e shërbimit programor, e punuar nga Agjencia për ushqim dhe veterinar, si organ kompetent për zbatimin e detyrave në fushën e sigurisë ushqimore (dhënë si shtesë në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-1280/1 nga 29.03.2022.). Shkelja nga pika 1 e këtij Vendimi, është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-1280/1 nga 29.03.2022., e cila është pjesë përbërëse e këtij Vendimi si Shtojcë nr.1.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi 3 nga LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndaj SHTR Televizion SITEL SHPKNJP Shkup më 29.03.2022., dërgoi Shkresë ark.nr.10-1280/2 nga 29.03.2022., ku dorëzoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.10-1280/1 nga 29.03.2022., ku në afat kohor prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të paraqesë një deklaratë me shkrim për shkeljen e dispozitave nga LSHMAAV. Në afatin e parashikuar, SHTR Televizion SITI SHPKNJP Shkup nuk u deklarua për shkeljen e kryer. Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 15.04.2022 ka shqyrtuar Raportin me shkrim dhe konkludoi ndaj SHTR Televizion SITI SHPKNJP Shkup, për shqiptim të masës – vërejtje publike.

Në lidhje nga sa u përmend më lartë, bazuar në nenin 18 paragrafi 1 alinea 20 dhe nenin 23 paragrafi 1 alinea 1 nga LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 53 paragrafi 5 dhe paragrafin 17 alineja 2 nga Ligji, pika 4 i Udhëzuesit për përcaktimin e afatit për të vepruar sipas vendimit të Agjencisë për marrjen e masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-6039/1 nga 20.10.2015. dhe Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.10-1280/1 nga 29.03.2022., për konstatim të mosrespektimit të dispozitave nga LSHMAAVe përcaktuar në pikën 1 të këtij Vendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e 15-të e mbajtur më 15.04.2022., në pajtim me Konkluzionin ark.nr.02-1682/7 nga 15.04.2022., miratoi Vendim ku publikisht paralajmërohet SHTR Televizion SITI SHPKNJP Shkup dhe detyrohet menjëherë pas pranimit të vendimit të harmonizojë punën e tij me dispozitat e LSHMAAV. Agjencia do të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse objekti i mbikëqyrur, i paraqitur në pikën 1 të këtij Vendimi, ka vepruar sipas Vendimit.

Në pajtim me nenin 24 paragrafet 1 dhe 2 nga LSHMAAV, ky Vendim është përfundimtar dhe kundër tij mund të ngrejë kontest administrativ para gjykatës kompetente. Padinë për kontest administrativ paraqitet në afat kohor prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

Bazuar në sa u tha më sipër, u miratua vendim si në dispozitiv.

**Agjencia për shërbime mediatike
audio dhe audiovizuale,**

Kryetar i Këshillit,

Lazo PETRUSHEVSKI d.v

Këshillë juridike: Në kundërshtim të vendimit radiodifuzeri ka të drejtë të ngrejë padi për kontekst administrativ pranë gjykatës kompetente. Padinë për kontekst administrativ paraqitet në afat kohor prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

Shtojca (1):

- 1) Raport me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.10-1280/1 nga 29.03.2022.

Dorëzuar tek:

- SHTR Televizion SITI SHPKNJP Shkup;
- Administratorit të Televizionit SHTR SITI SHPKNJP Shkup;
- Personit përgjigjës në SHTR Televizion SITI SHPKNJP Shkup;
- Sektorit për çështje juridike dhe prokurim publik;
- Sektorit për çështje programore; dhe
- Personit të autorizuar në Agjencion për udhëheqjen e regjistrat Up1.